

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Radiance Dental Hospital" shpk**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1) Sot, më 18.03.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Radiance Dental Hospital" shpk.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
 - a) Fabian Ndone, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër 038392504, dhe numër personal identifikimi H70203032D i datëlindjes 03.02.1977, lindur në Seman, Bashkia Fier dhe banues në rruga Mujo Ulqinaku, hyrja 1, Tirane, Njësia Administrative 10, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - b) Denis Reka, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BG0984776, dhe numër personal identifikimi J10909045M i datëlindjes 09.09.1991, lindur në Peshkopi dhe banues në rruga Gjon Mili nr.8, Tirane, Njësia Administrative 8, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - c) Marsid Kuqi, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër 037682290, dhe numër personal identifikimi J10131074T i datëlindjes 31.1.1991, lindur dhe banues në Tiranë rruga Zihni Sako, Pall. Desta Xhie, hyrja C.22, Njësia Administrative 4, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2:

Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Shërbime dentare, kura dentare, konsulencë dentare etj.
2. Shërbime dhe konsulencë në fushën e kirurgjisë plastike invazive dhe joinvazive etj.
3. Prodhimin, tregtimin, importin, shit-blerjen e implantëve dentare dhe materiale të tjera dentare.
4. Shoqëria, mund të ushtrojë aktivitete që lidhen me këto fusha: Laborator dentar, prodhimi, tregtimi, importi, shit-blerja e materialeve dhe pajisjeve mjekësore, importi dhe përdorimi i pajisjeve gjeneratore me rreze X. Call center, agjent shitje online, shërbim klienti online. Operator në fushën e rezervimit dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me realizimin e qëllimit të shoqërisë, marketing digjital, zhvillues digjital dhe krijimi i publicitetit dhe fushatave të marketingut dhe publicitetit;
5. Shoqëria, mund të kryejë për permbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të vendosë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ta hipotekojë këtë pasuri në rregjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj.
6. Përfitoje, transferoje, të marrë apo japë me qira, të blejë dhe shesë, si dhe të kontraktojë, të drejtën e markes, patentes, licences, dhe të drejtat e tjera që janë të ngjashme me këto.

2.2- Për realizimin e objektit të sipërpermender Shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shitje ose hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata të tjera të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

2.3 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet aktet normative sipas standarteve etike.

Neni 3

PERGJEGJESIA

3.1 Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave të tretë.

Neni 4:

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk*

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar.

Neni 5:**Selia**

- 5.1 Shoqëria e ka selinë në: Rruga Ismail Qemali, pallati Fratari, sipër bankës Intesa SanPaolo, Kati 1, Tiranë.
- 5.2 Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës Shqipërisë.
- 5.3 Faqja zyrtare në web e shoqërisë është: radiance.al.
- 5.4 Adresa elektronike për qëllime komunikimi zyrtar është: info@radiance.al

**KREU II
KAPITALI****Neni 6****Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000,000.00 (një milion) lekë.
- 6.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Fabian Ndone, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 510,000 (pesëqind e dhjetë mijë) leke që përben 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Denis Reka zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 245,000 (dyqind e dyzet e pesë mijë) leke që përben 24,5 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c) Ortaku themelues Marsid Kuqi zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 245,000 (dyqind e dyzet e pesë mijë) leke që përben 24,5 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Kontributi i ortakëve është në para dhe do të likujdohet nga ortakët brenda 7 ditëve nga data e hapjes së llogarisë së shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

Neni 7**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Mbledhja e Asamblesë së ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8**Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk*

- 4) Transferimi i kuotave të Shoqërisë dhe e drejta e ortakëve për t'u larguar nga Shoqëria i nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në nenet e këtij Statuti.
- 5) Transferimi i kuotave duhet të kryhet me shkrim.

NENI 9

1) Pa cenuar kufizimet dhe kushtet e parashikuara në Ligjin 9901 datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (më poshtë referuar si "Ligji Tregtar"), ortaku (më poshtë referuar si "Ortaku Transferues") që dëshiron t'i transferojë të tretëve të gjithë apo një pjesë të kuotës së tij në Shoqëri, apo çdo të drejte lidhur me të sipas Ligjit Tregtar, në çfarëdo forme dhe titulli, duke përfshirë, dhurimin, kontributin në natyrë apo shkëmbimin (në vijim "Kuota e Ofruar") do t'i komunikojë qëllimin e tij ortakëve të tjerë dhe Administratorit me letër te drejtuar ne selinë dhe ne adresat zyrtare te ortakeve me mjetet e komunikimit zyrtar te miratuara nga shoqëria. Ky komunikim do të përshkruajë në mënyrë të hollësishme natyrën e transferimit, do të përcaktojë saktë Kuotën e Ofruar dhe/ose të drejtat lidhur me të që do të transferohen si dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për identifikim e saktë të blerësit (në vijim "Blerësi i Mundshëm"), do të përcaktojë çmimin e ofruar të transferimit, mënyrat, kushtet dhe afatet e pagesës dhe garancitë e mundshme, dhe së fundmi do të përmbajë edhe ofertën për t'ia transferuar Kuotën e Ofruar ortakëve të tjerë sipas të njëjtave kushte me apo të parashikuara në komunikimin e Ortakut Transferues.

2) Transferimi i Kuotës së Ofruar të tretëve, do t'i nënshtrohet në çdo rast të drejtës së ortakëve të tjerë për të "Drejtën e Parablerjes. Pa cenuar detyrimin e njoftimit të ortakëve të tjerë sipas paragrafit të këtij neni, e Drejta e Parablerjes nuk zbatohet në rast transferimi të Kuotës së Ofruar midis ortakëve. Po ashtu, e Drejta e Parablerjes nuk zbatohet në rastin kur Blerësi i Mundshëm i tretë është një shoqëri e kontrolluar nga Ortaku Transferues.

3) Brenda tridhjetë (30) ditësh nga komunikimi i Ortakut Transferues sipas paragrafit më sipër, ortakët e tjerë mund të vendosin të ushtrojnë të Drejtën e Parablerjes, pra të pranojnë ofertën e Ortakut Transferues për të blerë Kuotën e Ofruar, duke ia komunikuar qëllimin e tyre Ortakut Transferues. Në rast se disa Ortakë vendosin të ushtrojnë të Drejtën e Parablerjes, Kuota e Ofruar do të ndahet mes tyre në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Transferimi i Kuotës së Ofruar do të kryhet në përputhje me parashikimet e neneve të këtij Statuti, brenda dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga komunikimi që i dërgohet Ortakut Transferues për pranimin e ofertës për blerjen e Kuotës së Ofruar.

4) Në rast se brenda afatit tridhjetë (30) ditor Ortaku Transferues nuk merr asnjë komunikim nga ortakët e tjerë, këta të fundit do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga e Drejta e Parablerjes.

5) Brenda (15) ditësh nga përfundimi i afatit për ushtrimin e së Drejtës së Parablerjes sipas paragrafit më sipër, do te jete Mbledhja e Ortakëve, për të vendosur në lidhje me miratimin apo jo të Blerësit të Mundshëm të tretë.

6) Vendimi i miratimit të Blerësit të Mundshëm të tretë duhet të miratohet nga Mbledhja e Ortakëve me unanimitet të gjithë Ortakëve të tjerë, duke marrë parasysh zotërimin nga ana e Blerësit të Mundshëm të Tretë të kapacitetit ekonomik, teknik dhe financiar të përshtatshëm për aktivitetin tregtar të Shoqërisë, mungesën e paragjyqimeve të këtij të fundit për realizimin e objektit të Shoqërisë apo konfliktin e interesit mes tij dhe Shoqërisë apo ortakëve të tjerë. Ortaku Transferues nuk mund të ushtrojë të drejtat e tij të votës në Mbledhje që do të mblidhet për të miratuar Blerësin e Mundshëm të tretë dhe kuota e tij nuk do të merret parasysh në llogaritjen e kuorumit të nevojshëm për mbledhjen e Ortakeve. Në rast se Ortaku Transferues nuk do të jetë i pranishëm në Mbledhje për të miratuar Blerësin e Mundshëm të tretë, vendimi i Mbledhjes do t'i njoftohet atij menjëherë me shkrim nga Administratori.

7) Refuzimi i miratimit të Blerësit të Mundshëm duhet të jepet nga Mbledhja e ortakeve brenda (15) ditësh nga përfundimi i afatit për ushtrimin e së Drejtës së Parablerjes sipas paragrafit (3) më sipër. Në rast se Mbledhja nuk merr vendim brenda këtij afati atëherë Blerësi i Mundshëm i tretë do të konsiderohet i miratuar dhe fillon procedurën ligjore për transferimin.

8) Në rastin kur miratimi i Blerësit të Mundshëm i propozuar nga Ortaku Transferues, refuzohet për shkaqe ku shkelet etika e shoqërisë, e arsyetuar nga pjesa tjetër e ortakeve, Ortaku transferues duhet te paraqesë kandidaturen e tij për Blerësin e Mundshëm dhe nese nuk ka nje blerës tjetër te mundshëm, Ortaku Transferues, me anë të një komunikimi me shkrim dërguar me letër rekomande Administratorit dhe ortakeve te tjere, do ketë të drejtë të largohet nga Shoqëria duke kërkuar likuidimin e kuotës së tij. Në rast largimi të Ortakut Ofrues, do të zbatohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit të parashikuara sipas këtij statuti.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk

9) Në rastin kur Blerësi i Mundshëm i tretë i propozuar nga Ortaku Transferues miratohet nga Mbledhja e ortakeve, atëherë transferimi i Kuotës së Ofruar, do të kryhet me çmimin, procedurat dhe kushtet e përcaktuara në letrën rekomande me kthim përgjigje dërguar sipas paragrafit më sipër, dhe jo më vonë se (30) ditë nga data e vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së ortakeve sipas paragrafit më sipër, ose brenda (30) ditësh nga marrja e njoftimit. Në rast se transferimi i Kuotës së Ofruar nuk kryhet sipas kushteve dhe afateve si më sipër, miratimi i Blerësit të Mundshëm të tretë do të konsiderohet i revokuar, dhe çdo shitblerje e mundshme e kryer do të jetë e pavlefshme për Shoqërinë.

10) Perjashtim nga e drejta e parablerjes do të behet vetëm në rastin e dhurimit të kuotave për pjestaret e familjes të ortakeve (fëmijët dhe/ose bashkëshortëve perkates).

NENI 10

Në rast vdekjeje të njërit prej ortakëve, do të ushtrohet e drejta e trashëgimisë. Ndërsa në rastin kur trashëgimtarët vendosin të shesin pjesën e trashëguar do të nenshtrohen procedurat duke respektuar të drejtën e parablerjes ndaj ortakeve të tjera, sipas nenit 9 të këtij Statuti.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11 Organi Vendimmarrës

- 1) Mbledhja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Mbledhja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj
- 3) Mbledhja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për punonjësit,
 - f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të vepronjë si përfaqësues i ortakeve në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12 Mënyra e thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme

- 1) Mbledhja e Përgjithshme e Ortakeve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dërguar me postë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, në adresat të cilat

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk




ata i kane depozituar në shoqëri, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

- 2) Kur Mbledhja e Përgjithshme e Ortakeve nuk është thirrur sipas pikes 1, ajo mund të marre vendime të vlefshme nëse të gjithë ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar që do të jenë të pranishëm janë dakort për të marre vendime, pavarësisht parregullsise.
- 3) Mbledhja e Përgjithshme e Ortakeve mblidhet në mënyrë të rregullt, të paktën një herë në vit në datën e caktuar dhe siç parashikohet në dispozitat ligjore.
- 4) Asambleja mund të mblidhet në vendin e caktuar nga Ortakët dhe nëse nuk do të përcaktohet një vend tjetër ose aplikacion online për ndjekjen e saj, vendi ku do të mblidhet, do të jetë selia e shoqërisë. Mbledhja mund mbahet me conferece-call, audio, audio-video në përputhje me nenin 88 të ligjit.
- 5) Dokumentat që dalin prej mbledhjeve të ortakeve janë: Vendimet dhe Procesverbali i Mbledhjes i cili nënshkruhet nga Kryesuesi i Mbledhjes dhe mbjtësi i saj. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme.

Neni 13

Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Mbledhja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) për qind të kuotave të kapitalit.
- 2) Në rastin kur Mbledhja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) për qind të kuotave të kapitalit janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit.
- 3) Nëse Mbledhja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, Mbledhja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Në këtë rast kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve është 51 (pesëdhjetë e një) për qind e kuotës së kapitalit.

Neni 14

Marrja e vendimeve

- 1) Mbledhja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Mbledhja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve;
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 15

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Mbledhja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk

- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16 Administrimi

- 1) Mbledhja e përgjithshme emëron një administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 3) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 4) Administratori i shoqërisë emërohet:

Fabian Ndone, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër 038392504, dhe numër personal identifikimi H70203032D i datëlindjes 03.02.1977, lindur në Seman, Bashkia Fier dhe banues në rruga Mujo Ulqinaku, hyrja 1, Njësia Administrative 10, Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 17 Kompetencat e Administratorit

- 1) Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Mbledhja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin sëbashku me ekspertin kontabël dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) Punësojë punonjës me orar të plotë apo të shkurtuar, për mbarëvajtjen e punës dhe aktivitetit të shoqërisë.
 - i) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - j) Kryejë të gjitha pagesat në emër dhe për llogari të shoqërisë, në përputhje me rregullat e administrimit financiar.
- 2) Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Mbledhja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk

Neni 18
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasoja e marrëveshjeve të pa miratuara nga Mbledhja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u pague ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pague për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.

KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 19
Viti Financiar

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20
Ekspertet

- 1) Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 2) Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk*

detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 21

FITIMI

- 1) Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pasi zbriten të gjitha shpenzimet përfshirë këtu edhe huatë, si edhe fondet e lëna rezerve për nxitje ekonomike, për investime për reklame tregtare, ndahen ndërmjet ortakeve në përputhje me përqindjen e kapitalit themeltar që ka secili ortak.
- 2) Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Mbledhja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Mbledhja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisë rezervat statutorë ose të shpërndajë dividend.
- 3) Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", përpara se të vendoset për shpërndarje dividendet, administratori lëshon çertifikatë të aftësisë paguese. Kjo çertifikatë lëshohet vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU V

PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 22

Prishja dhe likuidimi

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 23

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 24

Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radlance Dental Hospital" shpk

Neni 25
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që lind midis ortakëve, shoqërisë e paleve të treta, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky Statut u firmos në tri kopje të barabarta në gjuhën Shqipe

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Radiance Dental Hospital" shpk

Fabian Ndone

FABIAN NDONE



Denis Reka

Denis
Reka



Marsid Kuqi

Marsid Kuqi



Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Radiance Dental Hospital" shpk